



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit
Drejtoria e Arsimit
Datë: 23.10.2024

Bazuar në dispozitat e nenit 62, paragrafi 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/15 Qershor 2008), Statutin e Komunës Nr. 01/38717, të dates 07.11.2019 dhe në dispozitat e nenit 6 të Rregullorës nr. 01/10619 dt. 06.04.2023, për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës shpallë:

KONKURS

PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË DEÇANIT

- I. Komuna e Deçanit ndanë bursa, jo më pakë se 400 euro për studentët e studimeve bachelor të cilët studiojnë në ndonjërin nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës dhe Universitetet Publike jashtë Kosovës për vitin akademik 2023/2024.
- II. **Kushtet për konkurrim për bursë komunale:**
 - Të jetë banor i Komunës së Deçanit (vendbanim të përhershëm);
 - Të jetë student i rregullt në vitin akademik, në ndonjërin nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës dhe Universitetet Publike jashtë Kosovës
 - Të jetë student i nivelit Bachelor;
 - Të mos e ketë përsëritur (humbur) vitin akademik;
 - Të jetë student i vitit të dytë e më lartë;
 - Të kenë regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
 - Të kenë notë mesatare të studimeve së paku **8.5 (tetë pikë pesë)**
 - Përfundimisht bëjnë pjesë studentët e:
 - a) Fakultetit Teknik;
 - b) Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore:
Departamenti i Matematikës;
Departamenti i Fizikës;
Departamenti i Kimisë;
 - c) Fakultetit i Mjekësisë;
 - d) Fakulteti i Arteve.



Studentët e këtyre lëmive të studimeve kanë të drejtë për bursë edhe me notë mesatare më të ulët se (8.5), por jo më pak se 7.5 (**shtatë pikë pesë**).

Studentët e këtyre kategorive kanë bonus shtesë, prej (0.5 pikë) më tepër, në aspektin e notës mesatare, notë mesatare e përcaktuar në kriteret për bursë, sipas nenit 8 të rregullores si:

1. Personat me nevoja të veçanta;
2. Rastet sociale, gjendja e tyre ekonomike financiare;
3. Fëmijët e veteranëve, invalidëve dhe martirëve të luftës;
4. Studentët, prindërit e të cilëve kanë qenë të burgosur politik;
5. Studentët nga komunitetet;
6. Studentët që nuk i kanë prindërit, apo nuk jetojnë më prindër;
7. Studentët që vijnë nga familjet që kanë më shumë se dy studentë.

III. Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të bursave komunale:

Përzgjedhja e përfituesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat, bazuar në kriteret e specifikuar më poshtë.

Nëse një kandidat plotëson më shumë se një nga kriteret/kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati). Nëse kandidatët mbesin me pikë të barabarta, atëherë vendoset duke i dhënë përparësi kategorive të luftës, gjinisë femërore dhe studentëve që udhëtojnë në distancë më të madhe.

Nr.	Kriteri/Kategoria	Pikët
1.	Nota mesatare mbi 9 (nëntë)	40
	Nota mesatare mbi 8 (tetë)	30
	Nota mesatare mbi 7 (shtatë)	20
2.	Studentët me nevoja të veçanta	20
3.	Studentët me asistencë sociale	20
4.	Studentët – fëmijët bonjak (pa asnjërin prind)	15
5.	Studentët-fëmijët që kanë mbetur pa prind si pasojë e luftës (fëmijët e dëshmorëve dhe/ose viktimave civile)	30
6.	Studentët-fëmijët e invalidëve të UÇK-së	10
7.	Studentët-fëmijët e veteranëve të UÇK-së	05
8.	Studentët që studiojnë më shumë se një drejtim studimi - mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoraturë).	10
9.	Studentët që kanë edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtari tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoraturë).	10

10	Studentët në Fakultetin e Mjekësisë	20
11	Studentët në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, Gjuhës Gjermane	20

Studenti duhet ti ketë minimumi 40 pikë nga kriteret e lartë cekura

IV. Statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante, siç përshkruhet më poshtë.

- Konkursi vlenë për të gjithë studentët e Komunës së Deçanit, të cilët studiojnë në ndonjërin nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës dhe Universitetet Publike jashtë Kosovës

V.

Aplikacioni duhet të ketë këto dokumente të përgjithshme:

- Formularin e aplikimit të plotësuar (merret në zyrën pritëse nr.1) ose shkarkohet nga faqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/decan/category/njoftimetshpalljet/>;
- Dokumentin personal (letërnjoftimin ose pasaportën),
- Ekstraktin e lindjes,
- Kartelen Identifikuese të studentit,
- Vërtetimin nga Universiteti Publik (fakulteti apo departamenti përkatës) se kandidati është student i/e rregullt në vitin akademik 2023-2024, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik.
- Certifikatën e notave të studimeve (Origjinale),
- Çertifikata mbi vendbanimin e përhershëm

Studentët e kategorive të shënuara më lartë duhet të dorëzojnë këto dokumente të veçanta:

- Studentët me nevoja të veçanta, vërtetimin nga institucioni përkatës,
- Studentët me asistencë sociale, vendimin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët bonjak, certifikatat e vdekjes së prindërve,
- Studentët – fëmijët e Dëshmorëve/viktimave civile, vendimin se është përfitues i pensionit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët – fëmijët e Invalidëve të luftës, vendimin se është përfitues i pensionit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët – fëmijët e Veteranëve të luftës vendimin se është përfitues i pensionit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët që studiojnë më shumë se një drejtim studimi, dëshmi nga Fakulteti për drejtimin tjetër përveç atij që aplikon për bursë,
- Studentët që janë dy apo më shumë nga familja e ngushtë, dëshmi nga Fakulteti për statusin e studentit të anëtarit tjetër të familjes dhe certifikatën familjare,

Sqarime shtesë

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente përkatëse.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur prej datës 24.10.2024 deri më 07.11.2024, në afat prej 15 dite.

Aplikacionet dorëzohen në zarf të mbyllur, (në zyrën pritëse Kati – I) në Komunën e Deçanit.

Përfituesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale nga komisioni, dhe rezultatet do të publikohen në webfaqen e Komunës së Deçanit dhe në email të studentit.

Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosaj

